

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: nga të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Avokat nga kundër të paditurve: nga I të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av. dhe nga dhe nga, për shkak të vërtetimit të pronësisë, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: me datë: 12.04.2016 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VËRTETOHET** se paditësi: nga është pronar në bazë të mbajtjes me mirëbesim për më se 20 vite i pjesës së ngastrës: me sipërfaqe prej 104 m², i pjesës së ngastrës me sipërfaqe prej 2 m², i pjesës së ngastrës me sipërfaqe prej 78 m², pjesës së ngastrës me sipërfaqe prej 116 m² si dhe i pjesës së ngastrës me sipërfaqe prej 12 m², me masa dhe kufinjë si në skicën e terrenit që është pjesë e ekspertizës gjeodete të cilat ngatrsa evidentohen në emër të të paditurve ZK
- III. **OBLIGOHET** të paditurit që të drejtën e specifikuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njohin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojnë regjistrimin e kësaj të drejte në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me anë të padisë dhe në deklaratimet e të autorizuarit të tij në seanca gjyqësore kërkoi nga gjykata që të vërtetohet se paditësi është pronar mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim për më tepër se 20 vite i pjesëve së ngastrave të cekura si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Meqenëse të paditurve të parë, dytë dhe të tretë nuk dihej vendbanimi e as vendqëndrimi në përputhje me dispozitat ligjore e pas shterrjes së mundësive rreth sigurimit të adresës sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit gjykata ua caktoi përfaqësuesin e



Nga certifikatat e vdekjes dhe ekstraktete e lindjes vërtetoi legjitimiteti i paditësit dhe të paditurve, në rastet kur paraardhësit e të paditurve kanë vdekur e pjesa e ngastrave tani lëndore evidentohet në emër të tyre.

Në lidhje me bazën juridike e që paditësi të drejtën e tij e mbështet mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim, ku dëshmitari i cili u procedua deklaroi se ai në raporte të miqësisë me është qe 14 vite , mirëpo Hashimin me familje e njeh qe 40 vite dhe e di se ai ka qenë i vendosur aty, ndërsa asnjëher nuk ka dëgjuar që është penguar nga ndokush, e poashtu shtëpia e tani paditësit në raport me shtëpinë e dëshmitari është rreth 100-200 metra pra në të njëjtën lagje. Në raport me sipërfaqen dëshmitari deklaroi se është rreth 3-4 ari.

Në mungesë të provave të tjera që do të argumentonin të drejtën e paditësit, gjykata vendimin e vet e mbështeti në deklaratën e dëshmitarit si provë direkte, e cila gjen mbështetje edhe në provat tjera si vërtetimi i gjendjes faktike përmes këqyrjes direkte nga ana e gjyqtarit të qështjes, pastaj ekspertiza gjeodezike bashkë me dokumentet përcjellësi si skica e terrenit dhe kopja e planit.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, 28 të këtij Ligji, pasi baza juridike është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky ligj, mirëpo kjo e drejtë parashihet edhe me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe Të Drejtat Tjera Sendore.

Arsyeja e aplikimit të Ligjit të mëhershëm qëndron në faktin se baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky ligj.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kërkuan shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.792/2014 Datë: 12.04.2016



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykata e Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.